



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
Kuvendi i Komunës së Dragashit/ Skupština Opštine Dragaš



Kryetari i Komunës/ Presdenik Opštine/ Mayor

DATË/A:	03.03.2022
REFERENCË/E	
PËR/ZA/TO:	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Departamenti I Infrastruktures Rrugore
CC:	
NGA/OD/FROM :	Kryetari i Komunës së Dragashit z. Bexhet Xheladini
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rehabilitimi i rrugës Xërxe – Pllajnik në vlerë prej 336.764,00 €

Të nderuar,

Fshati Pllajnik është fshati më malor dhe më i largët i komunës së Dragashit.

Është i vetmi fshat i komunës i cili nuk është i lidhur me qendrën komunale me rrugë të asfaltuar. Rruga Dragash – Xërxe është asfaltuar vitet e kaluara. Pjesa e rrugës Xërxe – Pllajnik ka filluar të rehabilitohet në vitin 2018, ku Komuna e Dragashit dhe Ministria e Infrastrukturës kanë lidhur memorandum të mirëkuptimit për financimin e kësaj rruge. Ministria për vitin 2018 ka ndarë 100.000,00 €.

Pas shpenzimit të këtyre mjeteve vazhdimi i punimeve në këtë rrugë është ndërprerë në mungesë të mjeteve dhe neglizhencës së qeverisë komunale për të shtyrë këtë projekt përpara.

Kërkesës ja bashkëngjesim memorandumit të mirëkuptimit në mes ministrisë dhe komunës së Dragashit.

Dëshmi që Ministria e Infrastrukturës ka zotuar 100.000,00€ si dhe dëshminë e zyrës së prokurimit, gjegjësisht paramasës dhe parallogarisë për punët që janë kërkuar të kryhen dhe që kanë përfunduar me mjetet e ndara nga ministria.

Mbesim me shpresë se MMPHI do ta shqyrtojë pozitivisht këtë kërkesë dhe do ti mundësojë fshatarëve të fshatit Pllajnik qasje në qendrën komunale përmes rrugës së asfaltuar.

Me respekt,

Bexhet Xheladini
Kryetar i Komunës së Dragashit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš
02 Hn. Br. 400/01-4264/22
03.03.2022
Dragash - Dragaš